



Në mbështetje të nenit 6 dhe nenit 10, të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, si dhe nenit 6, të Rregullores Nr. 01/2022 për mënyrën e konkurrimit, procedurën e zgjedhjes dhe të propozimit të listës me emrat e kandidatëve për zëvendës të Avokatit të Popullit, Avokati i Popullit shpall:

K O N K U R S

për zgjedhjen e 1 (një) zëvendësi të Avokatit të Popullit nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë

Avokati i Popullit është institucion i pavarur që udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidentalitetit dhe profesionalizmit.

Avokati i Popullit në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nenin 133 paragrafin 2, Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe Rregulloren nr. 01/2022 për mënyrën e konkurrimit, procedurën e zgjedhjes dhe të propozimit të listës me emrat e kandidatëve për zëvendësit e Avokatit të Popullit, shpall konkurs për 1 (një) pozitë të zëvendësit të Avokatit të Popullit nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

Avokati i Popullit me rastin e përzgjedhjes dhe propozimit të listës me emrat e kandidatëve për zëvendës të Avokatit të Popullit, në mënyrë të veçantë do të sigurohet që kandidatët e propozuar të janë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë me qëllim të përfaqësimit etnik, sipas përcaktimeve të nenit 133, paragrafit 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 10 paragrafit 5, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit.

Zëvendësi i Avokatit të Popullit zgjidhet me mandat 3 (tre) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes.

Kushtet për zgjedhjen e zëvendësit të Avokatit të Popullit

Kandidati për zëvendës të Avokatit të Popullit, duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë arsimim të lartë universitar;
- Të ketë karakter, ndershmëri dhe moral të lartë;
- Të ketë eksperiencë dhe njohuri të dalluara në fushën e të drejtave të njeriut;
- Të mos ushtrorë funksion në parti politike, të mos jetë deputet në legjislaturën e Kuvendit të Republikës së Kosovës që e zgjedhë atë apo anëtar i kabinetit qeveritar.

Dokumentet e obligueshme për aplikim:

- Aplikacioni i plotësuar me të dhënat e kërkuara;
- Çertifikata e shtetësisë së Republikës së Kosovës (e nxjerrë pas datës së shpalljes së konkursit);
- Kopja e diplomës universitare e vlefshme në Kosovë (e noterizuar);
- Çertifikata nga Gjykata dhe Policia e Kosovës për të kaluarën penale (originale dhe të nxjerra pas datës së shpalljes së konkursit);
- Dëshmia për përvojën e punës dhe/apo pasqyra ose vërtetimi nga Trusti;
- Deklarata nën betim që dëshmon mos ushtrimin e funksioneve në parti politike, të mos jetë deputet në legjislaturën e Kuvendit të Republikës së Kosovës që e zgjedh atë apo anëtar i kabinetit qeveritar;
- CV - autobiografia;
- Letra motivuese.

Afati i dorëzimit të aplikacioneve

Aplikacionet duhet të dorëzohen nga data 26 gusht 2022 deri më 9 shtator 2022, në orën 16.00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën: Rruga "Migjeni" nr. 21, ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës, kati dytë, Zyra nr. 4, 10000, Prishtinë, Kosovë ose përmes postës elektronike e-mail: info.oik@oik-rks.org

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në shërbimin përkatës të administratës të Institucionit të Avokatit të Popullit, ose forma elektronike: web faqja e Institucionit të Avokatit të Popullit www.oik-rks.org.

Informata të tjera plotësuese mund të merren çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: + 383 (0) 38 223 782, 223 783, 223 789.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara.

Aplikacionet e pa kompletuara sipas kriterëve për aplikim, si dhe të dorëzuara pas afatit të përcaktuar me konkurs, nuk do të merren parasysh.